



INSTITUTI ALB-SHKENCA

NË BASHKËPUNIM ME:
UNIVERSITETIN E EVROPËS JUGLINDORE (SHKUP)
UNIVERSITETIN E TETOVËS (TETOVË)
UNIVERSITETIN “NËNË TEREZA” (SHKUP)
dhe
KOMUNËN ÇAIR TË SHKUPIT

THIRRJE

për kumtesa dhe pjesëmarrje në

**TAKIMIN XIII VJETOR NDËRKOMBËTAR
TË INSTITUTIT ALB-SHKENCA**
me temë plenare

**BOTA SHQIPTARE NË PËRKUJTIM TË 550-VJETORIT TË VDEKJES SË GJERGJ
KASTRIOTIT – SKËNDERBEUT**



Shkup, 1 – 3 shtator 2018

Instituti Alb-Shkenca, strukturë shkencore joqeveritare e jofitimprurëse që bashkon studiues të të gjitha disiplinave shkencore nga diaspora dhe nga mbarë trojet shqiptare në Ballkan, institucioni i parë shkencor mbarëshqiptar dhe më i madhi deri më tash, njofton fillimin e përgatitjeve të Takimit të tij XIII Vjetor Ndërkombëtar.

Takimi XIII i Institutit Alb-Shkenca me temë plenare

Bota shqiptare në përkujtim të 550-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit – Skënderbeut

do t'i zhvillojë punimet në Shkup, në datat 1 - 3 shtator 2018.

Ftohen anëtarët e Institutit Alb-Shkenca dhe të gjithë studiuesit e tjerë nga strukturat akademike shqiptare nga rajoni dhe diaspora, kërkuesit shkencorë të pavarur, si dhe shkencëtarë të huaj të lidhur ose jo me çështjet shqiptare, të marrin pjesë në këtë tubim të madh shkencor.

Në pajtim me frymën dhe traditën e Institutit Alb-Shkenca, të interesuarit janë të ftuar të kumtojnë në Takim arritjet e tyre më të reja në fushat e tyre të hulumtimit e të ekspertizës shkencore.

KONFERENCAT SHKENCORE NË KUADËR TË TAKIMIT XIII

I. Konferenca Ndërdisciplinore e Terminologjisë

II. Konferenca e Seksionit të Shkencave të Filologjisë, të Historisë e të Kulturës

III. Konferenca e Seksionit të Shkencave të Drejtësisë

IV. Konferenca e Seksionit të Shkencave të Bujqësisë

V. Konferenca e Seksionit të Shkencave të Ekonomisë

VI. Konferenca e Seksionit të Shkencave të Natyrës dhe të Mjedisit

VII. Konferenca e Seksionit të Shkencave të Mjekësisë

VIII. Konferenca e Seksionit të Shkencave Inxhinierike dhe të Teknologjisë së Informacionit.

IX. Konferenca e Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Politike

X. Konferenca ndërdisciplinore: “Informatika e aplikuar në shkencat e tjera”

DËRGIMI I PUNIMEVE

Përmbledhjet e punimeve për miratim sipas seksioneve

- Përmbledhja do të jetë dygjuhësh (shqip dhe anglisht);
 - Përmbledhja duhet të përmbajë 500 - 800 fjalë;
 - Përmbledhja duhet të përmbajë: titullin, autorin kryesor, bashkautorët dhe adresat e tyre; qëllimin e punimit, metodën e përdorur, si dhe përshkrimin e rezultateve.
- **Përmbledhjet** duhet të regjistrohen **ONLINE** nëpërmjet sistemit **ALPA**, në adresën: <http://iash-takimet.org> (shqip) ose: <http://iash-meetings.org> (anglisht)

Data me rëndësi:

Afati përfundimtar i dërgimit të përmbledhjeve..... **30 prill 2018**
Pranimi/refuzimi i përmbledhjeve..... **25 maj 2018**
Dërgimi i punimit të plotë për botim..... **30 qershor 2018**
Pagesa e pjesëmarrjes **deri më 30 qershor 2018**

Dërgimi i punimeve për botim sipas seksioneve

- Punimi duhet të jetë në shqip ose në anglisht;
- Punimi duhet të përmbajë 1000 – 2000 fjalë
- Punimi duhet të përmbajë: titullin, autorin kryesor, bashkautorët dhe adresat e tyre; abstraktin, hyrjen, pjesën kryesore, përfundimin dhe literaturën.

Pagesa e pjesëmarrjes në Takimin XIII është:

- Për pjesëmarrësit: **50 Euro**
- Për studentët (master dhe doktorat): **10 Euro**

Pagesa e pjesëmarrjes në Takimin XIII pas datës 30 qershor 2018 është:

- Për të gjithë: **100 Euro**

Në këtë participim përfshihet **dosja e konferencës** (*programi, bexhi, stilolapsi, notesi; libri i punimeve të plota, certifikata e pjesëmarrjes dhe kokteji*).

Pagesat e pjesëmarrësve bëhen në llogarinë e mëposhtme bankare (ose gjatë mbajtjes së Takimit):

(1) Procredit Banka – Shkup_Alb – Shkenca

Nr. i llogarisë: 380 – 1 – 261336 – 001 – 34 (në denarë)

IBAN: / MK07380126133601298 (në valute të huaj)
ProCredit Bank, Macedonia
SWIFT: PRBUMK 22XXX

(2) Tiranë (BKT)

Adresa Bankare:

BKT - Tiranë për Institutin Alb – Shkenca

Nr. llogarisë: 507360001

IBAN: AL8420511571360001CLTJCFEURA

SEIFT: NCBAALTX

(3) Prishtinë (filialat e BKT-së në Kosovë)

BKT ka filiale të saj edhe në Kosovë, ku mund të bëhet pagesa pa komision shtesë.

INFORMATA SHITESË PËR TË INTERESUARIT

- Kumtesat duhet të jenë origjinale (të pakumtuara në ndonjë aktivitet tjetër), të pabotuara dhe jo në proces vlerësimi ose botimi (në ndonjë redaksi tjetër).
- Një autor, mund të paraqitet në Takim më së shumti **me 2 (dy) punime** gjithsej: një (1) si autor i parë dhe një (1) si autor i dytë.
- Përmbledhjes së kumtesës duhet t'i prijë shënimi se në cilën konferencë dëshironi të paraqiteni.
- Përmbledhja e kumtesës duhet të jetë në **shqip** dhe **anglisht**, formatuar sipas modelit-tip të rregullave të IASH-së, që mund t'i shihni në faqen e Takimit në adresën:

[www.http://iash-takimet.org](http://iash-takimet.org)

- Redaktimin dhe lekturimin gjuhësor të tekstit të përmbledhjeve e bën secili autor për vete. **Përmbledhjet e paredaktuara e të palekturuara nuk pranohen!**
- Kumtesat dhe i gjithë komunikimi gjatë Takimit XIII do të zhvillohen në gjuhën shqipe ose angleze.
- **Udhëzimet e përgatitjes së punimeve janë në sistemin ALPA, në adresën:**
<http://alpa.mali-it.eu/journal/aktet/cfp/>
- **Punimet e plota dhe Përmbledhjet regjistrohen ONLINE** nëpërmjet sistemit **ALPA**, në adresën:

<http://iash-takimet.org> (shqip)

ose <http://iash-meetings.org> (anglisht).

Shënim: Informata shtesë lidhur me programin, si dhe udhëtimin drejt Shkupit (për pjesëmarrësit nga jashtë) do të jepen në mënyrë plotësuese.

Ju mirëpresim!

